

Përgjigja e plotë e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar studentëve për petitionin ku kërkojnë që provimi i jurisprudencës të mbahet edhe në gjuhën shqipe:

Në Ministrinë e Drejtësisë është dorëzuar Peticion nga studentë shqiptarë nga fakultetet juridike për të drejtën e mbajtjes së provimit të jurisprudencës në gjuhën shqipe. Sipas pretendimeve në petition, studentët kërkojnë që provimi i jurisprudencës të mbahet në gjuhën shqipe, si dhe materialet të jenë në gjuhën shqipe.

Ministria e Drejtësisë, me kujdes të posaçëm e shqyrtoi petitionin e dorëzuar dhe në kuadër të kompetencave të veta ligjore ju njofton si në vijim:

Në përputhje me nenin 1 paragrafi (1) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 7/19), në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Sipas paragrafit (2) të po të njëjtit nen, gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në përputhje me këtë ligj.

Sipas paragrafit (3) të po të njëjtit nen, në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridik që ushtrojnë autorizime publike në përputhje me ligjin dhe institucionet e tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, është edhe gjuha të cilën e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

Sipas paragrafit (4) të po të njëjtit nen, në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Në përputhje me nenin 2 paragrafi (1) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 7/19), qytetarët kanë të drejtë ta përdorin cilëndo nga gjuhët e theksuara zyrtare dhe alfabetet e tyre nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet e tjera e kanë për obligim që t’u mundësojnë qytetarëve shfrytëzim, përdorim dhe zbatim të atyre gjuhëve zyrtare

dhe alfabeteve të tyre në cilëndo qoftë procedurë, si edhe zbatim të atyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe në atë alfabet.

Sipas paragrafit (2) të po këtij neni, në pajtim me të drejtën e qytetarëve që ta përdorin cilëndo nga gjuhët e cekura zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe procedurat tjera të parapara me ligje tjera. Gjykatat, prokuroritë publike, si dhe të gjitha organet tjera, trupat dhe institucionet tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e cilëndo prej gjuhëve zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në ato procedura dhe procedura tjera.

Sipas paragrafit (3) të po këtij neni, në institucionet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarim, objekte infrastrukturore, evidencën amë, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe në sferat tjera.

Me nenin 2 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve parashikohet e drejta që qytetarët, kur iu drejtohen institucioneve të sistemit, të përdorin cilëndo gjuhë prej gjuhëve zyrtare dhe alfabetin e tyre, ndërsa institucionet kanë për obligim që t`ua mundësojnë shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e këtyre gjuhëve zyrtare dhe alfabetet e tyre në cilëndo procedurë si dhe zbatimin e këtyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe alfabetin e saj.

Në lidhje me Kërkesën tuaj për dhënien e provimit të jurisprudencës në gjuhën shqipe, konsiderojmë se zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve nuk mund të shqyrtohet në mënyrë të izoluar, por në korelacion me rregulloret e tjera relevante, edhe atë: me Ligjin për avokatinë, Ligjin për gjykatat, Ligjin për prokurorinë publike, Ligjin për përmbarim dhe Ligjin për noterinë, si tërësi. Përkatësisht, provimi i jurisprudencës është parakusht themelor për të hyrë në profesione të ndryshme në sistemin e gjyqësorit, e me këtë rast nga natyra dhe qëllimi i këtyre

profesioneve buron edhe nevoja e njohjes aktive të gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Prandaj, qëllimi dhe roli i provimit të jurisprudencës lidhen drejtpërdrejt me sigurimin e gatishmërisë profesionale dhe gjuhësore për kryerjen e profesioneve të lartpërmendura, dhe për këtë arsye, në përputhje me të njëjtën, theksojmë se:

Në përputhje me nenin 45 paragrafi (1) alineja 2 e Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 96/19), një nga kushtet për zgjedhjen e gjyqtarit është që personi të zotërojë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase.

Në përputhje me nenin 61 të Ligjit për prokurorinë publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/20), për prokurorë publik mund të emërohet gjegjësisht të zgjidhet një person, i cili e zotëron në mënyrë aktive gjuhën maqedonase.

Në përputhje me nenin 12 paragrafi (1) alineja 5 i Ligjit për avokatinë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 199/23), një Regjistrin e avokatëve mund të regjistrohet person i cili, ndër të tjera, duhet patjetër të flasë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase.

Në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Akademinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 129/23 dhe 53/24), kusht për pranim në trajnimin fillestar në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë është njohja aktive e gjuhës maqedonase.

Në përputhje me nenin 33 të Ligjit për përmbarimin (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 72/16, 142/16, 233/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 14/20 dhe 154/23), kusht për emërimin e përmbaruesit është gjithashtu njohja aktive e gjuhës maqedonase, si dhe sipas nenit 10 paragrafi (1) të Ligjit për noterinë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 72/16, 142/16 dhe 233/18), njohja aktive e gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik është kusht për emërimin e një personi si noter.

Meqenëse sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve, gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik është gjuhë zyrtare në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe se krahas gjuhës maqedonase, gjuhë zyrtare është edhe gjuha që flitet nga të paktën 20% e popullsisë që flet një gjuhë tjetër përveç maqedonishtes, kushti për njohjen aktive të gjuhës maqedonase

është i domosdoshëm gjatë dhënies së provimit të jurisprudencës, e që në esencë paraqet kusht që të jepen të gjitha provimet e cekura që janë kusht për zgjedhjen e personit për gjykatës, prokuror publik, avokat, noter dhe përmbarues.

Kontrollimi për njohjen aktive të gjuhës maqedonase kryhet pikërisht përmes dhënies së provimeve në gjuhën maqedonase.

Gjegjësisht, të gjitha procedurat zhvillohen në gjuhën maqedonase, e me kërkesë të qytetarit, ato zhvillohen edhe në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve, dhe për këto arsye, njohja aktive e gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik si gjuhë zyrtare është e domosdoshme nga gjyqtarët, prokurorët publikë, avokatët, veçanërisht noterët dhe përmbaruesit, si persona me autorizime publike që zhvillojnë procedura përkatëse. Gjithashtu, të gjitha vendimet, shkresat e shkruara dhe aktet e tjera që rrjedhin nga procedurat e lartpërmendura, miratohen dhe lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, nëse gjyqtari, prokurori publik, pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person që flet gjuhë që flitet nga të paktën 20% e qytetarëve në Republikë, (neni 9 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve).

Të gjitha dispozitat e përmendura më lart të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe ligjet e tjera paraqesin një tërësi juridike që siguron sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike dhe ushtrimin efikas të të drejtave të qytetarëve para institucioneve kompetente dhe personave me autorizime publike që zbatojnë procedura përkatëse.

Në përputhje me nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Amendamenti VI), gjuha zyrtare në të gjithë territorin e Republikës dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Dispozita kushtetuese përcakton gjithashtu qartë se përdorimi i një gjuhe tjetër zyrtare lejohet në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji, pa deroguar nga pozicioni kushtetues i gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare kryesore. Përveç kësaj, Ligji për provimin e jurisprudencës nuk përmban dispozita për dhënien e provimit të jurisprudencës në një gjuhë tjetër përveç gjuhës maqedonase.